

Data: 08.01.2026

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje pajisje për sallën e mbledhjeve/qeverisë”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP)

31158100-9 Karikues baterishë

32224000-9 Aparate për transmetim televiziv

32323300-6 Pajisje video-konferencash

32341000-5 Mikrofonë

Vlera e fondit limit i kontratës: 6,066,823 (gjashtë milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e njëzet e tre) lekë **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohej në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 55, pika 4 (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar

që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi për artikujt në tabelën e paraqitur në Shtojcën Nr.7 të DST, ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallit që do të ofrohet, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”.

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik.

3.Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- **ISO 9001** “Për menaxhimin e sistemit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi

kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Në nenin 44 pika 1 të të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”.*

ISO 9001 “Për menaxhimin e sistemit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme) është standard ndërkombëtar që garanton se operatori ekonomik zbaton një sistem menaxhimi cilësie që përmirëson vazhdimisht proceset. Kërkesa për këtë certifikatë siguron që shërbimet ose produktet e kontratës do të përmbushin standarde të larta cilësie dhe do të kryhen me efikasitet.

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se artikujt me Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 sipas tabelës të paraqitur në Shtojcën Nr.7 të DST, janë sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatë CE ose ekuivalente e saj, si dhe të deklarojë se në momentin e dorëzimit, pajisjet do të shoqërohen me Deklaratën e Konformitetit EC/ Certifikatë CE ose ekuivalente e saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, neneve 8, 9,10,11 dhe 12 i ligjit nr. 10489 date 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, nenin 40 pika 8 dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Deklarata nga operatori ekonomik se pajisjet e ofertuar janë sipas normave të Konformitetit EC/ Certifikatat CE ose ekuivalente e saj dhe në momentin e dorëzimit të pajisjeve në Autoritetin Kontraktor përfitues pajisja të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit EC / Certifikatat CE ose ekuivalente e saj, kërkohet për të demonstruar përmbushjen e kërkesave me të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj produktit, përfshire dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se garancia e pajisjeve do të jetë jo më pak se 3 (tre) vite sipas përcaktimeve të shtojcës 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallin që ofron dhe se do t’i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit apo instalimit të tij.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merr përsipër instalimin, vënien në punë dhe testimin e pajisjeve.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se instalimi, vënia në punë dhe testimi i pajisjeve do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues brenda parametrave optimalë për të funksionuar siç duhet, në përmbushjen e funksionalitetit të tyre dhe përmbushjes korrekt të qëllimit për të cilin kërkohen këto pajisje, duke siguruar Autoritetin Kontraktor se pajisja është në funksion të plotë dhe sipas rregullave.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME TEKNIKE – SISTEM KONFERENCE WIRELESS

ACCESS POINT WIRELESS

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi “Type”:	Access point i komunikimit për sistemin wireless të konferencave
Protokoll komunikimi:	I dedikuar për sisteme konferencash ose ekuivalent
Frekuenca operative “frequency”:	2.4 GHz / 5 GHz, ose ekuivalente
Shpejtësia e transmetimit:	≥ 54 Mbps
Frekuencë përgjigjeje:	80–20,000 Hz
Ethernet:	10/100/1000BASE-T
Audio input:	-18 dBV min, 18 dBV max
Audio output:	-18 dBV min, 20 dBV max
Wireless :	IEEE 802.11n
Input voltazh “Input voltage”:	100 VAC – 240 VAC, 50 Hz; 60 Hz
Tripod:	2200 x 1320 x 1320 mm
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Me të gjithë aksesorët e nevojshëm për tu vendosur në punë
Shërbim montimi :	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

WIRELESS DISCUSSION UNIT TOUCHSCREEN

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi “Type”:	NJËSI DISKUTIMI WIRELESS ME EKRAN TOUCH
Ekrani “Display” :	4.30 inch Touchscreen
Permasa:	72 mm x 259 mm x 139 mm
Input voltazh “Input voltage”:	7.50 VDC (paketë baterie)
Frekuenca operative “frequency”:	2.4 GHz / 5 GHz, ose ekuivalente
Frekuencë përgjigjeje:	80–20,000 Hz
Kohë operimi:	> 20 orë (20% të folur, 80% dëgjim)
Audio input:	80 dB SPL (IEC60914) min, 110 dB SPL (IEC60914) max
Audio output:	≥72 dB SPL
NFC:	NFC Të jetë e paisur me NFC (Near Field Communication) për të identifikuar përdoruesin ose ekuivalent.
Wireless :	IEEE 802.11n
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Me të gjithë aksesorët e nevojshëm për tu vendosur në punë

Shërbim montimi :	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

MIKROFON

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi “Type”:	Mikrofoni me direktivë të lartë (High directive microphone)
Input voltazh “Input voltage”:	5 VDC
Bandwidth:	100 Hz – 15 kHz
Gama dinamike:	> 96 dB
Audio input:	≥ 80 dB SPL (IEC60914)
Përmasa:	Jo më i gjatë se 110 mm
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Me të gjithë aksesorët e nevojshëm për tu vendosur në punë
Shërbim montimi :	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

PAKETË BATERIE

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi “Type”:	Bateri
Input voltazh “Input voltage”:	7.5 VDC
Kapaciteti:	≥ 12,800 mAh
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

KARIKUES BATERISH

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi “Type”:	KARIKUES BATERISH
Input voltazh “Input voltage”:	100–240 VAC, 50 Hz / 60 Hz
Slote karikimi:	≥ 5x
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Me të gjithë aksesorët e nevojshëm për tu vendosur në punë
Shërbim montimi :	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vite

KASE TRANSPORTI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
--	--

Tipi “Type”:	Kasë e fortë transporti
Permasat:	318 x 801 x 529 mm
Pesha:	11 kg
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Me të gjithë aksesorët e nevojshëm për tu vendosur në punë
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vite

TELEVIZOR

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi “Type”:	OLED, QLED me Shtresë Anti-Reflektive. Ose Ekuivalente
Madhësia “Size”:	≥ 80 ”
Rezolucioni “Resolution”:	≥ 4K 3840 x 2160 me 60 Hz
Smart:	Po
Portat Hyrëse “Input ”:	(3) HDMI, (1) USB, (1) LAN
Telekomandë “Remote Control”:	Po
Audio:	20w
Wireless :	Po
Bluetooth 5.2:	Po
Cast:	Apple AirPlay 2, Miracast ose Ekuivalente
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Me të gjithë aksesorët e nevojshëm për tu vendosur në punë
Shërbim montimi :	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

MBAJTESE TELEVIZORI

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi “Type”:	Mbajtëse televizori me rrota (Mobile TV Stand / Rolling TV Cart) – ose ekuivalente
Përputhshmëria “Compatibility”:	E përshtatshme për televizor OLED / QLED ≥ 80”
Kapacitet Mbajtës “Load Capacity”:	Të mbajë peshë deri në 50 kg ose më shumë
Materiali “Material”:	Kornizë metalike (çelik i galvanizuar) me rezistencë të lartë – ose ekuivalente
Lartësia e Rregullueshme “Height Adjustment”:	Po
Lëvizshmëria “Mobility”:	Me 4 rrota të forta (≥ 360° rotacion), sistem bllokimi (brake lock)
Rrafte Shtesë “Additional Shelves”:	Platformë për pajisje (kamera, laptop, media box)
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Me të gjithë aksesorët e nevojshëm për tu vendosur në punë
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vite

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, Kryeministria, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT